


NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLIJE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#120

QSPA/ "Continuum" për herë të parë një revistë e dedikuar për Arbëreshët



"Continuum" është emri i revistës shkencore të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Tashmë është botuar numri i parë i kësaj reviste vjetore që është konceptuar në përputhje me misionin e QSPA, si pjesë e botimit të studimeve të specializuara për historinë, gjuhën, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh.

Në këtë kuadër, revista synon të nxisë bashkëpunimin mes studiuesve vendas dhe atyre në Diasporë e më gjerë, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e strukturës së studimeve mbi komunitetin arbëresh, dhe shërben si një forum për shkëmbimin e ideve dhe debateve shkencore. Realizimi i saj bëhet i mundur nga Drejtoria e Studimeve dhe Publikimeve pranë QSPA, në bashkëpunim dhe me studiues të tjerë brenda dhe jashtë vendit.




"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimin e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

TAKIMI/ KKD me ministren e jashtme të Kosovës: Diaspora interes i përbashkët

Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës (KKD) zhvilluan një takim online me Ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Republikës së Kosovës znj. Donika Gërvalla dhe Zëvendësministren e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, znj. Liza Gashi, ku prezantuan punën e KKD-së.

Kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës Z. Mark Gjonaj duke e falënderuar ministren e Jashtme të Kosovës, dhe të pranishmit e tjerë prezantoi një përmbledhje të punës së deritanishme të KKD-së, duke theksuar së prej krijimit të Këshillit, anëtarët e tij kanë bashkëpunuar dhe janë angazhuar vazhdimisht për çështjet që kanë të bëjnë me përfaqësimin e interesave të shqiptarëve të larguar nga vendlindja dhe forcimin e marrëdhënieve të tyre me vendlindjen.



Aplikacioni "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare" zëri i biznesit në Diasporë

Gjithçka në "pëllëmbë të dorës" nëpërmjet aplikacionit "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare - ADBC". Informacion të arritshëm për bizneset, sipërmarrësit, anëtarët e Diasporës në Shqipëri, si dhe funksione të ndryshme



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë



Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online



Diaspora Shqiptare

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS

App store: [këtu](#)

Play store: [këtu](#)



Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.